

Pobërgjë/Pobrde më 1.06.1998. Banorët e braktisën menjëherë fshatin. Osmonin e moshëthyer, kushëriri Muhameti e kishte çuar me veturë në fshatin **Voksh/Vokša**. Sipas disa burimeve, të cilat i ka kontaktuar familja e Osmonit, ai gjendej në **Voksh/Vokša** për disa ditë me radhë. Më 5 apo **6.06.1998**, ishte nisur me qëllim që të kthehet në **Pobërgjë/Pobrde**, por kurrë nuk ka arritur atje. Pas tij nuk ka mbetur asnjë gjurmë. Konsiderohet ende i zhdukur dhe rasti i tij është evidentuar nga KNKK-ja, ndërkaq lënda e tij është e sistemuar me numrin rendor BLG-804597-01.

Burimet: deklarata A.F, FDH-18714; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Rexhep (Qerim) Jasharaj

(1906, shqiptar nga Strellci i Epërm/Gornji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani)

Rexhepi i moshuar jetonte vetëm në shtëpinë, e cila gjendej në pronën e të afërmit të tij, Demë Kapitaj, në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc. Shtëpinë ia kishte ndërtuar vetë Dema. Të shumtën e kohës, Rexhepi e kalonte në këtë shtëpi dhe me familjen e Demës. Kur më 25.05.1998, Dema me familje vendosën të kalonin në kolibën e vogël në bjeshkë [Strellci i Epërm/Gornji Streoc], Rexhepi vendosi të qëndronte në shtëpi. Atë ditë, familjarët e shihnin Rexhepin të gjallë për herë të fundit. Djali i Demës, Faiku, kishte mësuar nga disa bashkëfshatarë se policia serbe e kishte vrarë Rexhepin më **6.06.1998**, në afërsi të rrugës magjistrale Pejë/Peć – Deçan/Deçane. Më 8.06.1998, atë e kishte varrosur në oborrin e tij komshiu Nimon Hasanmetaj. Mbetjet mortore të Rexhepit janë rivarrosur në varrezat lokale më 15.07.1999.

Burimi: deklarata D.K, FDH-16360.

Shaban (Zeqë) Mazrekaj

(30.12.1968, shqiptar nga **Vokshi/Vokša**, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Shabani e ka çuar bashkëshorten dhe familjen e të vëllait në Shqipëri më 5.06.1998, por ai vet u kthye po atë ditë në Kosovë. Të

nesërmen, më **6.06.1998**, sërish u nis për në Shqipëri. Për shkaqe sigurie, dëshironte ta çonte atje edhe nënën Timen. Përderisa i afroreshin **Junikut/Junik**, pjesëtarët e forcave serbe, të cilët ishin të pozicionuar në pyll mbi bjeshkën e *Rogopeqit/Rogopeć*, hapën zjarr në drejtim të tyre. Shabanin e qëlluan në gjoks dhe në qafë. Dha shpirt në vend. Nëna e tij u plagos në duart. Dikush e çoi atë në ambulancën e fshatit Dobrosh/Dobroš. Të nesërmen, më 7.06.1998, të afërmit shkuan për të marrë trupin e Shabanit. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e fshatit të lindjes të **Vokshit/Vokša**. UÇK e ka shpallur Shabanin dëshmor lufte.

Burimet: deklarata I.M, FDH-18699; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFĐUÇK, *Feniksët...* 7, 275-278; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Isuf (Camë) Mazrekaj

(26.03.1938, shqiptar nga **Vokshi/Vokša**, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Isufi ka mbetur në fshatin **Voksh/Vokša** me djalin Isniun dhe kushëririn Musë Zekajn nga Carrabregu/Crnobreg, kur forcat serbe filluan sulmin mbi fshatin e tyre. Në datën **7.06.1998**, nga ora 08:00, Isufi ka dal prej shtëpisë, duke i thënë Musës se po shkonte në pyll ku gjendeshin pjesëtarë të UÇK-së. Pasi nuk u kthye atë ditë, Isni u nis për ta kërkuar atë. Ushtarët e UÇK-së i kanë thënë se Isufi as që ishte paraqitur tek ata. Isufit i është humbur çdo gjurmë nga ajo ditë. KNKK-ja e ka regjistruar zhdukjen e tij në lëndën me numrin rendor BLG-80-1404-01.

Burimet: deklarata I.M, FDH-18715; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Elaz (Fazli) Dautaj

(1922, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, bujk)

Elazi jetonte në bashkësi me nipin Musën dhe familjen e tij. Kurrë nuk u martua. Musa me familje e kanë braktisur fshatin Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg më 2.06.1998, ndërkaq Elazi ka mbetur vetëm